



032
04.05.2020
SEKRETERIA
PREFEKTI I QARKUT



7

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2030/Prot.
/2

Elbasan, më 04.5.2020

VENDIM

Nr. 45 datë 04.5.2020

“Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.179 datë 04.12.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin 2020”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 07.05.2020, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Administrata dhe Kryetari i Bashkisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB nr.179 datë 04.12.2019 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Elbasan, për vitin 2020”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9920 datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.9975 datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- VKM nr.132 datë 07.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar;
- Ligjin nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i ndryshuar;
- Urdhërin të MSHMS nr.132 datë 08.3.2020 “Për mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike dhe anulimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura”, i ndryshuar;
- Urdhërin e MSHMS nr.156 datë 10.3.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”;
- Urdhërin e MSHMS nr.164 datë 12.3.2020 “Për mbylljen e bareve, restoranteve, lokaleve, fast food dhe kufizimin e shërbimeve që ofrohen nga strukturat akomoduese që ofrojnë shërbim për klientët”;
- Urdhërin e MSHMS nr.193 datë 20.3.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”;
- Udhëzimit të ISHP me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19;

VENDOSI:

1. Pikat 3 dhe 4 të Aneksit 2, të Tabelës A, riformulohen si më poshtë:

3. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato

zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas vlerës referuese për Bashkinë Elbasan. (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 15.090 = 30,18\ lekë$).

4. Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshirë ato të njërive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas vlerës referuese për Bashkinë Elbasan. Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura. (Shembull: $Vlera\ për\ m^2 = 1\ m^2 \times 0,2\ \% \times 25.150 = 50,3\ lekë$)”.

2. Paragrafi i parafundit i Aneksit 2, të Tabelës A, ndryshohet si më poshtë:

“Për sa i përket kategorisë së ndërtesave që përdoren, shfrytëzohen për veprimtari ekonomike nëse subjekti nuk ka realizuar deklarinin nëpërmjet dorëzimit të dokumentacionit të pronësisë vlerësimi realizohet sipas VKM nr.132 datë 07.3.2018, i ndryshuar”.

3. Tek pika 7, Tabela B, në fund shtohet fjalia si më poshtë:

“Për periudhën Mars - Maj 2020, subjektet përjashtohen nga detyrimi për të vetëdeklaruar numrin e netëve të qëndrimit në hotel”.

4. Pika d Tabela C, të riformulohen si më poshtë:

d.	Për projekte të infrastrukturës publike, për ndërtimin rrugësh, ujësjellësash, kanalizimesh, në pronësi të Bashkisë Elbasan.	0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit;
----	--	---

5. Të krijojë lehtësira fiskale ndaj biznesit në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit COVID - 19, si më poshtë:

a) Përfshirjen nga detyrimi i pagesës së tarifës për zënie e hapësirës publike (Tabela G), për periudhën Mars - Maj 2020;

b) Përfshirjen nga detyrimi i pagesës së tarifave të shërbimit në tregje, për periudhën Mars - Maj 2020, nga subjektet të cilët kanë marrë në përdorim ambientet e tregjeve fruta - perime - bulmet”.

5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë.

6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Klajd Gripshi

KRYETARI

Fektor Çiftja





5

633
07.05.2020
REPUBLICA E SHQIPËRISË
SECRETARIA
PREFEKTI I QARKUT

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 2029 Prot.
12

Datë 07 .05. 2020

VENDIM

NR. 46 DATË 07 .05. 2020

MBI

“Transferim mallrash nga Qendra Ekonomike e Arsimit në Qendrën Sociale “Balashe”.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës 07 . 05. 2020, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Për transferim mallrash nga Qendra Ekonomike e Arsimit në Qendrën Sociale “Balashe”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrit të Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe VKM nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqsisë natyrore”

VENDOSI :

1. Transferimin e mallrave ushqimorë nga Qendra Ekonomike e Arsimit në Qendrën Sociale “Balashe”, për tu përdorur nga kjo e fundit për vaktet e përgatitura çdo ditë për azilin dhe personat në nevojë që trajtohen nga kjo qendër, në funksion të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqsisë natyrore”.
Vlera e përgjithshme e artikujve që do të transferohen është 166,530 lekë.
2. Qendra Ekonomike e Arsimit, në transferimet e ardhshme të buxhetit, do të kompesohet për fondin e përdorur nga kuotat ushqimore për likuidimin e faturave të mallrave ushqimorë të transferuar sipas pikës 1 të këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë, Qendra Ekonomike e Arsimit, Qendra Sociale “Balashe” dhe Drejtoria e Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Prefekti.

**SEKRETAR
Klajd Gripshi**



**KRYETARI
Hektor Ciftja**